



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës

PROJEKTVENDIM

NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2025

PËR

MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.05, DATË 10.03.2025, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQIND MIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM”

Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, shkresës nr. 2221/16 prot., datë 19.11.2025, dalë nga Grupi i punës drejtuar Ndërmarrjes Rruga; shkresës nr.739/1 prot., datë 19.11.2025, ardhur nga Ndërmarrja Rruga, shkresës nr. 2221/18 prot., datë 21.11.2025, dalë nga grupi i punës drejtuar Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Shkrese nr. 2221/20 prot., datë 02.12.2025, dalë nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, drejtuar Grupit të punës, i ngritur me urdhër nr. 158, datë 14.05.2024, sipas relacionit të pregatitur nga Drejtoria Ligjore, kryetari i bashkisë, i propozon këshillit bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 05, datë 10.03.2025, “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 400 703.84 (katërqind mijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”. për shkak të ndryshimit në projekt, si më poshtë:

a. Ndryshimin e listës emërore të pasurive të prekura nga shpronësimi, nga 16, në 24, sipas listës së bashkëlidhur këtij vendimi, e cila zëvendëson plotësisht listën e miratuar me VKB nr.5/2025.

b. Ndryshimin e vlerës totale të shpronësimit, nga 400 703.84 (katërqind mijë e shtatëqind e tre, pikë tetëdhjetë e katër) lekë, në 565344.88 (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e katër pikë 88) lekë, në përputhje me vlerësimet financiare të pasurive shtesë të konstatuara në terren.

c. Për shkak të konstatimeve teknike në terren dhe ndryshimeve të ndjekura në zbatim të Lejes Infrastrukturore në fuqi, të cilat kanë sjellë identifikimin e pasurive shtesë të prekura nga projekti, bëhet e domosdoshme ndryshimi i VKB nr.5/2025, për të siguruar korrektësinë ligjore dhe teknike të procedurës së shpronësimit.

d. Zëvendësimin e tabelës që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 05, datë 10.03.2025, me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e tij.

e. Fondi i shpronësimit me vlerë 565344.88 (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e katër pikë 88) lekë, të parashikohet në buxhetin e vitit 2026. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.

2. Ky vendim është pjesë e vendimit të këshillit bashkiak nr. 05, datë 10.03.2025.

3. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sktori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.


**DREJTORIA LIGJORE**

Alneida Broshi



**KRYETAR**

Emiriana Sako





**LJISTA PARAPRAKE E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI: RIKONSTRUKSIONI RRUGA  
ISHEM**

| Nr. |                       | PRONARI              |                       |      |         | TË DHËNA HIPOTEKORE |             |        |         |          |       |      |                        |                               |              | VLERSIMET PËR SHIPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË                                                                                                                                                                                                    |  |  |  |
|-----|-----------------------|----------------------|-----------------------|------|---------|---------------------|-------------|--------|---------|----------|-------|------|------------------------|-------------------------------|--------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
| Nr. | Emër                  | Atësi                | Mbretmer              | Z.k  | Nr. Pas | Lloji pas           | Sip. Tot    | Trrall | Arë     | Ndërtese | Volum | Faqe | Sip. (m <sup>2</sup> ) | ( mimi (tëqë/m <sup>2</sup> ) | Vlera (tëqë) | Shënime                                                                                                                                                                                                                                               |  |  |  |
| 1   | Gjok                  | SHITET               | Lazeri                | 1522 | 215     | KANAL               | 7000        |        | KANAL   |          | 2     | 194  | 0                      | 0                             | 0            |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 2   |                       |                      | Lazeri                | 1522 | 156/53  | Are                 | 4134        |        | PO      |          | 1     | 187  | 164.09                 | 320                           | 52508.8      |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 3   | Mylhar                | Musa                 | Lumeshi               | 1522 | 154/2   | Are                 | 4717        |        | PO      |          | 1     | 184  | 14.36                  | 320                           | 4595.2       |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 4   | Inçia 6 vllazeri shpk |                      |                       | 1522 | 156/97  | Are                 | 915         |        | PO      |          | 4     | 169  | 12.25                  | 320                           | 3920         |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 5   | Agrom                 | Vesed                | Bara                  | 1522 | 156/93  | Are                 | 600         |        | PO      |          | 4     | 165  | 150.91                 | 320                           | 48291.2      |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 6   | Inçia 6 vllazeri shpk |                      |                       | 1522 | 156/190 | Are                 | 26297       |        | PO      |          | 9     | 100  | 308.32                 | 320                           | 98662.4      |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 7   | Murati Group 012      |                      |                       | 1522 | 153/39  | Are                 | 2098        |        | PO      |          | 8     | 219  | 37.77                  | 320                           | 12086.4      |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 8   | Jak                   | Zef                  | Canoj                 | 1522 | 153/38  | Are                 | 1180        |        | PO      |          | 5     | 182  | 63.32                  | 320                           | 20262.4      |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 9   | Elton                 | Bahir                | Nuri                  | 1522 | 156/163 | TR+ND               | 166.66/61.4 | PO     |         | PO       | 6     | 109  | 33.48                  | 339                           | 11349.72     | Leje legalizimi nr.201543 date 18.05.2018 GODINE BANIMI I KT Sip.kati per dhe 61.4 m2                                                                                                                                                                 |  |  |  |
| 10  | Dorian                |                      | Ishaku                | 1522 | 156/164 | Are                 | 166.67      |        | PO      |          | 6     | 110  | 20.94                  | 320                           | 6700.8       |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 11  |                       | SHITET               |                       | 1522 | 148     | KENEFTE             | 6100        |        | KENEFTE |          | 2     | 230  | 0                      | 0                             | 0            | 2225. Mbi kete pasuri pozicionohet pjeserisht ndertesa e lagatizuar me nr. 147/148 ND. VOL. 9, FQ.89                                                                                                                                                  |  |  |  |
| 12  | Mikel Edlira          |                      | Reci                  | 1522 | 147/91  | Are                 | 500         | -      | PO      |          | 4     | 121  | 6.4                    | 320                           | 2048         |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 13  | Artur                 | Gjergj               | Muca                  | 1522 | 156/176 | Are                 | 500         |        | PO      |          | 7     | 183  | 41.45                  | 320                           | 13264        |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 14  | Mirando Dorian        | Perparim Perparim    | Bonaj Bonaj           | 1522 | 147/136 | Are                 | 1004        |        | PO      |          | 7     | 194  | 187.63                 | 320                           | 60041.6      |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 15  | Gjergj                | Zef                  | Semena                | 1522 | 147/121 | TR+ND               | 4010/1400   | PO     |         | PO       | 5     | 75   | 8.84                   | 339                           | 2996.76      | L.I.E.G.GODINE.SOC EKO I KT.SIP 1400m2 PLOTESI AR SIPAS VOL.FIZIK                                                                                                                                                                                     |  |  |  |
| 16  |                       | SHITET               |                       | 1522 | 212     | Rruge               | 1800        |        | RRUGE   |          | 2     | 191  | 0                      | 0                             | 0            |                                                                                                                                                                                                                                                       |  |  |  |
| 17  | Agim Dod Esmeralda    | Myslim Llesh Abdulla | Sinjomeri Docit Docit | 1522 | 147/10  | Are                 | 7160        |        | PO      |          | 1     | 16   | 269.21                 | 320                           | 86147.2      | VHJET NE HIP NE FAVOR TE SHOQ INCO SHPK ME K.SIPERMARRJE NR.5145/630 DT.18.07.2008 NOT.N.KARADAKU. ME NR.REFERENCE 1710 REALIZOHET KONTRATA E SHKENBIMIT PER PRONARET E TRUALIT DOD DOCI DHE ESMERALDA DOCT. K.SHKENBINI NR. 4113/1667, DT.01.09.2021 |  |  |  |

|       |                        |                      |                           |      |        |       |     |  |  |    |  |   |     |        |     |           |                                                                                                     |
|-------|------------------------|----------------------|---------------------------|------|--------|-------|-----|--|--|----|--|---|-----|--------|-----|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 18    | Tomorr<br>Musa<br>Gjon | Seti<br>Lanc<br>Pren | Simoni<br>Basami<br>Boshi | 1522 | 147/45 | Are   | 196 |  |  | PO |  | 3 | 116 | 2.55   | 320 | 816       | Eshte ne proces gjuqesor per pjesetim pasurie, me kerkesa padie nr. 2010 date 25.01.2010. ref 0891  |
| 19    | Tomorr                 | Seti                 | Simoni                    | 1522 | 147/46 | Are   | 500 |  |  | PO |  | 3 | 117 | 40.89  | 320 | 13084.8   | 2225. Mbi kete pasuri pozicionohet pjeserisht ndertesa e lagajzuar me nr. 147/148/ND. VOL. 9, PQ.89 |
| 20    | Abdulla                |                      | Hoxha                     | 1522 | 147/24 | Are   | 360 |  |  | PO |  | 3 | 20  | 30.8   | 320 | 9856      | Vihet ne Hip ne favor te BK 6me K/HIP 719/594 dt. 19.05.2005                                        |
| 21    | Nikoll                 |                      | Lazeri                    | 1522 | 154/12 | Are   | 320 |  |  | PO |  | 4 | 46  | 2.53   | 320 | 809.6     | Kjo pas eshte proces gjuqesor K. PADI                                                               |
| 22    |                        |                      |                           | 1522 | 150/3  |       |     |  |  |    |  |   |     | 239.22 | 320 | 76550.4   | Nuk na eshte vene ne dispozicion kartela nga ASHK                                                   |
| 23    |                        |                      |                           | 1522 | 152/30 |       |     |  |  |    |  |   |     | 129.23 | 320 | 41353.6   | Nuk na eshte vene ne dispozicion kartela nga ASHK                                                   |
| 24    |                        | Shitet               |                           | 1522 | 211    | Kamat |     |  |  |    |  |   |     | 0      | 0   | 0         | Nuk na eshte vene ne dispozicion kartela nga ASHK                                                   |
| TOTAL |                        |                      |                           |      |        |       |     |  |  |    |  |   |     |        |     | 565344.88 |                                                                                                     |

Grupi i Punës:

Enli Kaculi

Jetmir Kurti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

RELACION

**PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.05, DATË 10.03.2025, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQIND MIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM”**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

**K ë t u**

*I. Objekti*

Ky relacion paraqet arsyet dhe bazën ligjore për ndryshimin e VKB nr.5/2025, lidhur me miratimin e vlerës së shpronësimit të investimit publik: “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”, projekt i cili zbatohet në bazë të Lejes Infrastrukturore nr. AN031220250006, datë 03.12.2025 me nr. 1526-25 Prot.

*II. Çfarë parashikonte VKB nr.5/2025*

*Me VKB nr.5, datë 10.03.2025 është vendosur:*

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 400 703.84 lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: “Rikonstruksion Rruge në Njësinë Administrative Ishëm”.
2. Fondi i shpronësimit me vlerë 400 703.84 lekë të parashikohet në buxhetin e vitit 2025. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.

*III. Ndryshimet në projekt – bazuar në Lejen Infrastrukturore*

Gjatë fazës së verifikimit të gjurmës së shpronësimit dhe në përputhje me kërkesat teknike të Lejes Infrastrukturore nr. AN031220250006, datë 03.12.2025 me nr. 1526-25 Prot., janë realizuar:

- rivekurimi i gjurmës së rrugës mbi bazën e matjeve të përditësuara gjeodezike;
- ripërcaktimi i disa segmenteve të punimeve, për të garantuar siguri konstruktive dhe funksionalitet rrugor;



- harmonizimi i projektit me rrjetin ekzistues të infrastrukturës, duke përfshirë degëzimet e mëparshme të rikonstruara nga Ndërmarrja Rruga;
- identifikimi i pasurive që mbeten brenda perimetrit të prekjeve, të cilat nuk rezultojnë në listën fillestare.
- Këto ndryshime teknike janë të zakonshme në fazat e detajuara të matjeve dhe nuk lidhen me mangësi të grupit të punës, por me qartësimin përfundimtar të gjendjes faktike në terren.

#### *IV. Shkaqet e domosdoshme të ndryshimit të VKB nr.5/2025*

Në vijim të punës përgatitore dhe të verifikimeve në terren, u konstatuan rrethana objektive që imponojnë domosdoshmërinë e ndryshimit të VKB-së:

##### *1. Zgjerimi i pasurive të prekura nga projekti*

- Nga matjet gjeodezike rezultoi se projekti prek më shumë pasuri private se ato të evidentuara fillimisht (nga 16 pasuri në 24 pasuri).

##### *2. Segment i rikonstruktuar më parë nga Ndërmarrja Rruga*

- U identifikua një degëzim i rikonstruktuar më parë, gjë që solli modifikim të vijës së re të ndërhyrjes.

##### *3. Pasuri të mbetura jashtë listës fillestare për arsye të ruajtjes së pronës private*

- Në fazën paraprake, disa pasuri nuk u përfshinë me qëllim që të mos prekej prona private, pasi fillimisht nuk dukej e nevojshme për funksionin e projektit.
- Pas verifikimit teknik përfundimtar u konstatua se për zbatim korrekt të projektit dhe të Lejes Infrastrukurore, këto pasuri duhet të përfshihen.

##### *4. Përditësimi i vlerës financiare*

- Shtimi i pasurive të prekura rrit automatikisht vlerën e shpronësimit, nga 400 703.84 lekë në 565344.88 (pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e katër pikë 88) lekë.

#### *V. Nevoja dhe rëndësia e ndryshimit*

Ndryshimi i VKB-së është thelbësor për:

- garantimin e korrektësisë ligjore dhe teknike të procedurës së shpronësimit;
- respektimin e kërkesave të Lejes Infrastrukurore;
- përgatitjen e saktë të projekt-VKM-së së shpronësimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- shmangien e ngërceve procedurale dhe vonesave;
- fillimin e investimit publik të rëndësishëm për komunitetin e Njësisë Administrative Ishëm.

#### *VI. Përfundime*

Në përputhje me ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar; VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar; VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM-në nr. 395, datë 13.05.2021, "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", miratimi i këtij projektvendimi është hap

i detyrueshëm për të vijuar procedurat e shpronësimit dhe për të garantuar zbatimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës sipas standardeve ligjore dhe teknike.

***Pjesë e këtij relacioni është:***

- Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.05, datë 10.03.2025.
- Tabela që do i bashkëlidhet vendimit që pritet të miratohet nga ky këshill.
- Shkresa nr. 2221/16 prot., datë 19.11.2025, dalë nga grupi i punës, drejtuar Ndërmarrjes Rruga
- Shkresa nr. 739/1 prot., datë 19.11.2025, ardhur nga Ndërmarrja Rruga.
- Shkresë nr. 2221/18 prot., datë 21.11.2025, dalë nga grupi i punës, drejtuar Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.
- Shkrese nr. 2221/20 prot., datë 02.12.2025, dalë nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, drejtuar Grupit të punës, i ngritur me urdhër nr. 158, datë 14.05.2024.
- Leja Infrastrukturës nr. AN031220250006, datë 03.12.2025 me nr. 1526-25 Prot.
- Kartelat e pasurisë dhe HTR për 24 pasuri që preken nga projekti.

**DREJTORIA LIGJORE**

**Alneida Broshi**

